



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. Protokolit 581

Me Datë: 20. 04. '19

Rahovec, 2019

-III- Nr. i prot. 581 Më 20.05 2019
Br. prot. 581 Dt. 20.05 2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009) dhe Ndryshim Plotësimit të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010, nenit 21, 44 dhe 108 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016) si dhe kërkesës së subjektit kërkues-Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr.Prot. 134 të datës 26.11.2018 dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe deklaratave të palëve brenda afatit ligjor, Kryetari i Komunës së Rahovecit merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

- SHPRONËSOHET** paluajtshmëria për interes publik për hapjen e rrugës publike “Edit Durham” në Rahovec, si vijon:
Ngastra kadastrale Nr. **P-71510057-06163-1** në sipërfaqe të përgjithshme prej **2533 m²** ku nga kjo sipërfaqe e përgjithshme do të ndahet pjesa e parcelës në sipërfaqe prej **148 m²** sipas çertifikatës së pronës së paluajtshme të evidentuar në emër të pronarit znj. Hanife (Hajredin) Rama nga Rahoveci.
- VËRTETOHET** se “hapja e rrugës publike “Edit Durham” në Rahovec” është qëllim i ligjshëm dhe me interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartcekur është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.
- Pronari i paluajtshmerisë së shpronësuar të ngastrës kadastrale Nr. P-71510057-06163-1 në sipërfaqe prej 148 m² të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2533 m², të evidentuar sipas çertifikatës së pronësisë në emër të znj. Hanife (Hajredin) Rama, kompenzohet në shumë prej 5,180.00 euro (pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë euro) dhe mjetet do të derdhen në xhirollogarinë e znj. Hanife (Hajredin) Rama.
- Vlerësimi për kompromis është bërë nga organi kompetent respektivisht zyra e veçantë për vlerësimin e pronës së paluajtshme të shpronësuar e cila vepron pranë Ministrisë për Financa.
- Në përputhje me paragrafin 8 të nenit 11 dhe nenit 16 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim si dhe pas plotësimit të kushteve të parapara me Ligj, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të Komunës së Rahovecit.
- Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi në datën e shpalljes në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Arsyetim

Subjekti kërkues – Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Rahovecit me kërkesën me Nr. Prot. 134 të datës 26.11.2018 ka kërkuar iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik për hapjen e rrugës “Edit Durham” në Rahovec, e cila ka për qëllim lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe që lidhet me rrugë të tjera kryesore të qytetit të Rahovecit.

Subjekti kërkues i kësaj kërkesë ia ka bashkangjitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitën e nenit 8 lidhur me nenin 4 të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës erdhi në përfundim se shpronësimi i paluajtshmërisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është në interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njëjtit qëllim dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se prona e paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimit diskriminues dhe se Organi Shpronësues lidhur me këtë çështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së paluajtshme për interes publik.

Organi shpronësues – Kryetari i Komunës me Vendim për pranimin formal të kërkesës për shpronësim Nr. 134 të datës 26.11.2018, ka miratuar kërkesën e subjektit kërkues – Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik.

Poashtu në afatin ligjor Organi shpronësues ka miratuar Vendimin Preliminar Nr. 27 të datës 16.01.2019 për shpronësimin e pronës së paluajtshme të evidentuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Brenda **5 (pesë)** ditëve të punës pas miratimit të vendimit përfundimtar, Organi shpronësues këtë vendim ia dërgon subjektit kërkues dhe personave të tjerë që janë bashkëpronarë dhe të identifikuar në këtë vendim përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa për shpronësimin e subjektit kërkues është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtën e paraqitjes së Ankesës në Gjykatën Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, në afat prej 30 ditësh kalendarike, pas datës së hyrjes së fuqi të këtij Vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- *Subjekti kërkues, DGJKP*
- *Pronarëve dhe zotëruesve të interesit, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

